



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**  
**DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Tiranë, më 01.02.2022

## **NJOFTIM PUNËSIMI**

Bazuar në Vendimin nr.35, datë 19.01.2022 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2022, në njësitë e qeverisjes qendrore”, AZHBR shpall njoftimin e punësimit për vendet e pa plotësuara si mëposhtë vijon :

### **I. SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT:**

SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë), kategoria IV-b

#### **Detyrat kryesore:**

1. Siguron që çdo nëpunës është në domain e AZHBR dhe është pajisur me një llogari personale.
2. Ofron suport për rrjetin kompjuterik dhe pajisjet në rastet kur ka nevojë në institucion.
3. Mbledh dhe zhvillon kërkesat për teknologjinë e informacionit, koncepton, vlerëson alternativat dhe rekomandon zgjidhje për përdorimin efektiv të teknologjisë së informacionit.
4. Përcakton pajisjet dhe programet që do të përdoren në sistemet e teknologjisë së informacionit për t’i shërbyer qëllimeve dhe nevojave të institucionit.
5. Përcakton se si do të merren dhe ruhen të dhënat, arkivimet, mbrojtjen, shpërndarjen, sigurinë e sistemit, si dhe përcakton cilët do të hyjnë dhe në cilat të dhëna.
6. Siguron edukimin e përdoruesve mbi funksionet e sistemeve dhe se si të përdorin me efektivitet pajisjet dhe programet për kryerjen e detyrave të ngarkuara.

## **Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:**

1. Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë Master Profesional, në Shkenca Kompjuterike, Inxhinieri elektronike, Informatikë, Teknologji informacioni, Inxhinieri telekomunikacioni.. *(Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi).*
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit
4. Të kenë njohuri të gjuhës angleze.
5. Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale

## **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

1. Njohuritë mbi Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.
2. Ligjin nr 152/2013 “Për nëpunësin civil”,
3. Njohuritë mbi Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
4. Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
5. Njohuritë mbi VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar.
6. Njohuri mbi ligjin për bazat e të dhënave shtetërore.
7. Njohuri mbi ligjin për dokumentin elektronik.
8. Njohuri mbi ligjin për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë.

**Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 03.02.2022, ora 16.30 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollesha”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.**

---

**TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONIN E MËSIPËRM, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al), PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:**

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

**Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al).**

## **AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**